

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikafloor® Level-30

LLAÇ ÇIMENTOJE PËR DYSHEME ME PERFORMANCË TË LARTË, I VETËNIVELUESHËM DHE ME THARJE TË SHPEJTË PËR MJEDISE TË BRENDSHME E TË JASHTME NË TRASHËSI 4–30 MM



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikafloor® Level-30 është llaç çimentoje dyshemeje, i modifikuar me polimere, i pompueshëm, i vetënivelueshëm dhe me tharje të shpejtë për trashësi të mëdha për dysheme në mjedise të brendshme ose të jashtme, që plotëson kërkesat e kategorisë R3 sipas EN 1504-3.

PËRDORIMET

Sikafloor® Level-30 është llaç dyshemeje i vetënivelueshëm për nivelim ose lëmim të llaçeve të dyshemeve në trashësi midis 4-30mm me një hap pune.

Sikafloor® Level-30 përdoret si llaç dyshemeje për kushte shërbimi industrial kur izolohet me veshje përfundimtare rrëshire PU ose EP për ngarkesë mesatare në të lartë (qarkullim i rëndë + pirunash me ngarkesë tronditëse).

Sikafloor® Level-30 është gjithashtu i përshtatshëm për mbushje, lëmim dhe nivelim të nënshtresave të përshtatshme përpara aplikimit të parketeve, pllakave qeramike, dyshemeje prej rrëshirë pa bashkime, tekstileve, mbulesave elastike të dyshemeve.

Sikafloor® Level-30 përdoret si llaç dyshemeje në mjedise të jashtme kur izolohet me një mbulim, p.sh. veshje.

- I përshtatshëm për punime restauruese (Parimi 3, metoda 3.1, EN 1504-9).
- I përshtatshëm për përforsim të strukturës (Parimi 4, metoda 4.4, EN 1504-9).
- I përshtatshëm për ruajtje apo restaurim të pasivitetit (Parimi 7, metoda 7.1 dhe 7.2, EN 1504-9).

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- I vetënivelueshëm dhe shumë fluid
- Aplikim i lehtë manual ose me pompë
- Gati për përdorim
- Tkurrije e ulët
- Ruan punueshmëri të mirë dhe ofron mbushje të fugave gjatë kohës së tij të punueshmërisë
- Mpiksje dhe tharje e shpejtë
- Mundësi për qarkullim me ecje pas 3-4 orësh (+20°C)
- Paraqitje dhe fortësi sipërfaqjeje e mirë
- Rezistencë e shkëlqyer ndaj ngrirjes-shkrirjes (R3)
- Pa kazeinë dhe formaldehide
- I përshtatshëm për përdorim me sistemet e ngrohjes nën dysheme

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

- EC 1plus R: Çlirime shumë të ulëta.

MIRATIME / STANDARDE

- Llaç dyshemeje me bazë çimentoje CT-C40-F10-A12 sipas EN 13813, deklaratë performance 90432755 dhe mbart markën CE
- Llaç dyshemeje me bazë çimentoje A1/A1fl sipas EN 13813, deklaratë performance 90432755, vlerësuar nga laborator i njoftuar 1140 dhe mbart markën CE
- Llaç dyshemeje me bazë çimentoje kategoria R3 për parimet 3 (CR), 4 (SS) dhe 7 (RP) sipas EN 1504-3, deklaratë performance 36581792, vlerësuar nga laborator i njoftuar 1139 dhe mbart markën CE

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	çimento e modifikuar me polimere dhe me mpiksje të shpejtë.
Ambalazhi	thes 25 kg

Paraqitja / Ngjyra	Pluhur - bezhë, gri
Jetëgjatësia	9 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +30°C.
Dendësia	~2.0 kg/l
Dendësi vëllimore (bulk density)	~1.25 kg/l

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj abrazionit	Kategoria	Vlera	Metoda	
	A12	12 cm ³ / 50 cm ²	Böhme	(EN 13892-3)
	AR 0.5	< 50 µm	BCA	(EN 13892-4)
	RWA 100	< 100 cm ³	RWA	(EN 13892-5)
Rezistenca ndaj ngjeshjes	Koha	Temperatura	Vlera	(EN 13892-2)
	24 orë	20 °C	~ 20 N/mm ²	
	28 ditë	20 °C	≥ 40 N/mm ²	
Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje	Koha	Temperatura	Vlera	(EN 13892-2)
	24 orë	20 °C	~ 3 N/mm ²	
	28 ditë	20 °C	≥ 10 N/mm ²	
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	Koha	Temperatura	Vlera	(EN 13892-8)
	28 ditë	+20 °C	≥ 1.5 N/mm ²	
Koeficienti i zgjerimit termik	α ~16.3×10 ⁻⁶ 1/°C (për shkallë temperature -20 °C dhe +40 °C)			(EN 1770)
Përthithja e ujit	W ~0.5 kg / (m ² × h ^{0.5})			(EN 13057)

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit	Prajmeri	Shih trajtimin paraprak të nënshtresës
	Nivelimi	Aplikoni në trashësinë e kërkuar 4–30 mm
	Izolues, veshje dhe adezivë	Sikafloor® Proseal 22 Sikafloor®-256W, -304W, -305W dhe -2540W Të gjitha llojet e veshjeve Sikafloor® EP dhe PU Sikabond® -T52, -T54, -T54FC p.sh. seria e produkteve SikaCeram® për kollat e pllakave

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes	5 deri 5.25 L ujë për 25 kg Sikafloor® Level-30
Konsumimi	~1.8 kg/m ² /mm
Trashësia e shtresës	4–30 mm
Temperatura e mjedisit	+10 °C min. / +25 °C max.
Lagështia relative e ajrit	< 75 %
Temperatura e nënshtresës	+10 °C min. / +25 °C max.

Përgatitja e nënshtresës

Qëllim përdorimi normal i dyshemesë

Rekomandohet prajmeri akrilik me 1 përbërës Sika® Level-01 Primer për një sipërfaqe pa pore me ndërkapje shumë të mirë të sipërfaqes. Referohuni tek skeda teknike përkatëse për detajet e rekomanduara të aplikimit etj.

Qëllim përdorimi për ngarkesa të mëdha të dyshemesë

Prjamer rrëshire epokside si Sikafloor® -155WN, Sikafloor® -156 ose Sikafloor® -161 spërkatje e plotë me rërë kuarci 0.4–0.7 mm.

Koha e punueshmërisë	Temperatura dhe lagështia relative e ajrit +23 °C / 50%	Koha ~ 25 minuta
-----------------------------	---	----------------------------

Temperatura do të ndikojë kohën e punueshmërisë.

Aplikimi në temperatura mbi +23°C do të reduktojë kohën e punueshmërisë dhe kohën e punës. Temperaturat nën +23°C do të zgjasin kohën e punueshmërisë dhe kohën e punës.

Koha e pritjes / mbiveshja	Mbulimi	Trashësia e shtresës	Koha e pritjes
	Veshje të papërshkueshme ose të ndjeshme ndaj lagështisë	≤ 15 mm	24 orë ¹
	Veshje të papërshkueshme ose të ndjeshme ndaj lagështisë	≤ 30 mm	48 orë ¹
	Pllaka qeramike	≤30 mm	~24 orë

1. Kohët jepen me përafërsi dhe në +23°C dhe 50% lagështi relative dhe kështu do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të nënshtresës dhe ambientit, veçanërisht temperatura dhe lagështia relative.

Kur mbivishni Sikafloor® Level-30 sigurohuni gjithmonë se përmbajtja e lagështisë ka arritur vlerën e kërkuar nga produkti i veshjes, pasi koha e pritjes do të ndryshojë me trashësinë e aplikimit dhe lagështinë e ambientit. (Referohuni tek skeda teknike e produktit të veshjes)

Produkti i aplikuar gati për përdorim	Në +20°C dhe 50% lagështi relative
	Qarkullim këmbësorësh ~ 3 orë
	Sforcim i lehtë ~ 24 orë

Shënim: Kohët jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të nënshtresës dhe ambientit, veçanërisht temperatura dhe lagështia relative.

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

- Nënshtresa e betonit duhet të jetë e qëndrueshme dhe me rezistencë të mjaftueshme ndaj kompresionit (> 25 N/mm²) me rezistencë minimale ndaj tërheqjes prej 1.5 N/mm².
- Sipërfaqja duhet të jetë e pastër, e thatë dhe pa kontaminues si p.sh. pislleqe, vaj, graso, veshje dhe trajtime sipërfaqesh etj.
- Në rast dyshimi, aplikoni më parë në një zonë për provë.
- Betoni i dobët duhet të hiqet dhe defektet sipërfaqësore si vrimat dhe boshllëqet duhet të ekspozohen plotësisht.
- Korja e çimentos, bojërat apo agjentë të tjerë të trajtimit të sipërfaqes duhet të hiqen plotësisht.
- Metoda të përshtatshme për përgatitjen e sipërfaqes janë pastrimi me rrymë uji në presion të lartë ose me rrymë abrazive. Trajtime të tjera paraprake si shkrifërimi, bluarja, etj. duhet të ndiqen me metodë shtesë përgatitjeje mekanike për të shmangur

defektet e mbetura të strukturës me synim përfundimtar heqjen e kores së çimentos dhe arritjen e një sipërfaqeje me teksturë të hapur dhe të qëndrueshme.

- Kusht paraprak për një ngjitje të mirë midis nënshtresës dhe llaçit nivelues të dyshemesë është ashpërsia e duhur e nënshtresës. Ashpërsia mesatare e sipërfaqes duhet të jetë sa më e madhe të jetë e mundur, por të paktën 1 mm.
- Riparimet mbi nënshtresë, mbushja e vrimave / boshllëqeve duhet të bëhen me produktet e përshtatshme nga seria e materialeve SikaTop®, Sika® MonoTop®, Sikafloor®, Sikadur® dhe Sikagard®.
- Pluhuri, materialet e lira dhe të shkrifëta duhet të hiqen plotësisht nga të gjitha sipërfaqet përpara aplikimit të produktit, preferohet me furçë dhe/ose fshesë elektrike.
- Pika e vesës: Kujdes kondensimin!
Nënshtresa dhe dyshemeja e patharë duhet të jenë të paktën 3°C mbi pikën e vesës për të reduktuar rrezikun e kondensimit, çngjyrosjes apo kores mbi

sipërfaqen përfundimtare.

- Prajmer i përshtatshëm akrilik me 1 përbërës Sika® - Level-01 Primer.
- Alternativë: Nëse nënshtresa është e fortë dhe ka teksturë mjaftueshëm të ashpër, Sikafloor® Level-30 mund të aplikohet direkt mbi nënshtresë. Shmangni flluskat duke njomur nënshtresën deri sa të arrihet një gjendje SSD (Saturated Surface Dry, Tharje e Saturuar e Sipërfaqes).
- Në rast ushtrimi forcash të mëdha mekanike mbi dysheme, aplikimi dyshemeje mbi dhë ose nënshtresa të dobëta duhet të lyhen me prajmer Sikafloor®-156 ose Sikafloor® -161 spërkatur plotësisht me rërë kuarci 0.4-0.7 mm. Shënime: nuk duhet aplikuar rërë kuarci me tepri dhe kokrrizat nuk duhet të izolojnë plotësisht me rrëshirë.
- Mos aplikoni mbi nënshtresa me lagështi në rritje. Nëse do të ketë lagështi rritëse, duhet të aplikohet një membranë e efektshme kundër lagështisë në përputhje me standardin përkatës kombëtar.

PËRZIERJA

Aplikim manual

Kur përzieni manualisht shtoni pluhurin e thatë (25 kg) brenda një ene me ujë të pastër.

Përzieni plotësisht për të paktën 3 min. me mikser elektrik, rekomandohet përdorimi i një mikseri me 2 akse të rrotullueshëm përzierjeje (< 500 rpm). Koha e maturimit: Pas përzierjes lëreni materialin të qëndrojë brenda enës për ~2 minuta derisa të jetë shpërndarë shumica e flluskave të ajrit.

Pompim

Kur përdorni pompë llaçi me pajisjen e përshtatshme (Putzmeister MP 20/25, DuoMix 2000 ose PFT G5 FE) rregulloni makinerinë në një mënyrë të atillë që të arrihet një miks i njëtrajtshëm.

Kontrolloni dozën e ujit për të arritur rrjedhën e kërkuar, duke matur mesataren përfundimtare të diametrit të rrjedhës mbi një bankë të sheshtë, të pastër dhe të thatë.

Vegla	Rrjedha	Standardi
Ø = 30 mm H = 50 mm	130 mm ± 5 mm	EN 12706
Ø 70 / 100 mm H = 60 mm	355 mm ± 10 mm	ASTM C 230-90 EN1015-3
Ø = 60 mm H = 120 mm	290 mm ± 10 mm	Metoda Sika AT

APLIKIMI

Hidheni materialin e përzierë mbi sipërfaqen e lyer me prajmer dhe aplikoni me mallë ose krëhër në trashësinë e kërkuar. Kaloni rulin me gjëmba në dy drejtime për të larguar ajrin e bllokuar. Koha më e mirë e aplikimit do të ishte gjatë rënies së temperaturave.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Nënshtresat shumë absorbuese duhet të ngopen me ujë ose të lyhen me prajmer për të parandaluar humbjen e ujit të përzierjes tek nënshtresa, e cila mund të shkaktojë probleme si tkurrja, shfaqja e poreve mbi sipërfaqe ose sipërfaqe të dobëta dhe të pluhurosura, etj.
- Mos përzieni me çimento apo llaçe dyshemeje të tjera me bazë çimentoje.
- Mos ngarkoni pesha për të paktën 3 orë.
- Sikafloor® Level-30 i freskët duhet të mbrohet nga lagështia, kondensimi dhe uji për të paktën 24 orë.
- Mos tejkaloji dozën e rekomanduar të ujit. Mos shtoni më tepër ujë kur produkti ka filluar të mpikset.
- Mos tejkaloji trashësinë e rekomanduar.
- Ndryshueshmëria në ngjyrë, teksturë, pore mbi sipërfaqe të lëndëve të para është normale për sistemet minerale (përbërës për nivelim dyshemesh) nuk ka arsye shqetësimi. Gjithashtu, në kushte të caktuara (thatësi, rrezatim diellor, lagështi e ulët, etj.) mund të priten plasaritje të holla mbi sipërfaqe.
- Për të siguruar konsistencën optimale të ngjyrës, është thelbësore që punimi i shtrimit të dyshemesë të jetë sa më i pastër dhe i mbrojtur nga ambienti.
- Sipërfaqja duhet të mbulohet në çdo rast, pavarësisht nëse aplikimi bëhet në mjedis të brendshëm apo të jashtëm.
- Temperaturat nën +20 °C zgjasin kohët e tharjes.
- Nuk është i përshtatshëm për pjerrësi > 0.5 %.
- Të mbrohet nga rrezatimi i drejtëpërdrejtë diellor, erërat e nxehta ose të forta dhe temperaturat ekstreme për të shmangur plasaritjen apo krisjen kapilare. Këto plasaritjet e vogla sipërfaqësore ose krisja kapilare janë dukuri normale në këto kushte dhe nuk përbëjnë arsye për ankimum.
- Kur mbivishni me SikaCeram® ose adezivët Sikabond® (apo të tjerë), mund të kërkohej përgatitje mekanike shtesë për të hequr koren e çimentos e cila mund të jetë formuar gjatë aplikimit.
- Rekomandohet testim paraprak kur do të përdoren produkte të tjera për veshje.
- Duhet të shmangët kontakti me strukturat vertikale duke vendosur shirit izolues në perimetër.
- Trashësia e llaçit nivelues duhet të jetë të paktën 4mm kur përdorni ngjitës me bazë uji nën dyshemetë e përfunduara të padepërtueshme ose të papërshkueshme nga avulli.
- Gjatë përdorimit si një R3 riparues për mbrojtje kundër karbonimit, Sikafloor® Level-30 duhet të përdoret gjithmonë në kombinim me një veshje të përshtatshme.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla saqë asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikafloor® Level-30

Mars 2019, Botimi 04.01

020815020010000015

SikafloorLevel-30-sq-AL-(03-2019)-4-1.pdf